



Duke u mbështetur në nenin 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 32, 33 dhe 53 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 11 paragrafi 1 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit, nenit 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1 si dhe nenit 7 dhe 8 të Rregullores për Përbërjen dhe Kompetencat e komiteteve, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të rregullt për vitin 2015, të mbajtur më 30.12, mori këtë:

V E N D I M

Për

Zëvendësimin e një anëtari të Komitetit për Politikë dhe Financa

I

Avni Gashi, anëtar i subjektit politik AKR zëvendësohet me anëtarin **Skënder Merturi**, nga Lëvizja Vetëvendosje që të dy anëtar të Kuvendit Komunal Klinë nga Grupi Kuvendar 3+.

II

Zëvendësohet anëtari i Komitetit për Politikë dhe Financa nga subjekti politik i AKR-së me anëtarin nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, sipas marrëveshjes së Grupit Kuvendar 3+(AKR-Vetëvendosje -PSHDK), të Kuvendit të Komunës së Klinës, sipas radhës.

Komiteti për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, si komitet i përhershëm, tani ka këtë përbërje:

1. Dr. Haxhi Ibishi - Kryesues
2. Halil Desku - anëtar
3. Ramush Agushi - “
4. Fadil Gashi- “
5. Pal Berisha- “
6. Ndue Shabanaj - “
7. Skender Merturi- “

II

Ky Komitet kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e etnive politike në Kuvendin e Komunës.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka përbërjen prej 7 anëtarëve, në proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor në Kuvendin e Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk mund të jenë anëtarë të komiteteve të tjera.

III

Përbërja dhe kompetencat e këtij Komiteti rregullohen me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit, si dhe Rregulloren për përbërjen dhe kompetencat e komiteteve.

IV

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01 Nr. 06-71/16
Klinë, më 30.12.2015.



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi